



BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVES
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

Raporti i Bilancit të Pagesave

M A R S 2 0 1 2 / N R . 1 1

BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

Raporti i Bilancit të Pagesave

Numër 11

BOTUES Banka Qendrore e Republikës së Kosovës ©
Departamenti i Stabilitetit Financiar dhe Analizave Ekonomike
33 Garibaldi, Prishtinë 10 000
Tel: ++381 38 222 243
Fax: ++381 38 243 763

FAQJA E INTERNETIT www.bqk-kos.org

ADRESA ELEKTRONIKE economicanalysis@bqk-kos.org; statistics@bqk-kos.org;

KRYEREDAKTOR Gani GËRGURI

REDAKTOR Arben MUSTAFA

AUTOREË Albulenë KASTRATI
Sokol HAVOLLI

REDAKTOR TEKNIK Butrint BOJAJ

SHTOJCA STATISTIKORE Departamenti i Statistikave

VËREJTJE: Përdoruesit e këtyre të dhënave kërkohen të citojnë burimin.
Citimi i sugjeruar: Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (2011),
Raporti i Bilancit të Pagesave Nr. 11, Prishtinë.
Çdo korigjim i nevojshëm bëhet në versionin elektronik.

SHKURTESAT:

BEC	Kategoritë Kryesore Ekonomike
PBB	Produkti i Brendshëm Bruto
IHD	Investimet e huaja direkte
EJL	Evropa Juglindore
BQK	Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
BQE	Bank Qendrore Evropiane
BE	Bashkimi Evropian
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
CPI	Indeksi i çmimeve të konsumatorit
PPI	Indeksi i çmimeve të prodhuesit
IPI	Indeksi i çmimeve të importit
NNEK	Norma Nominale Efektive e Këmbimit
REER	Norma reale efektive e këmbimit
CEFTA	Marrëveshja Mbi Tregtinë e Lirë në Evropën Qendrore
KFOR	Forca Ushtarake e NATO-së në Kosovë
EULEX	Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit
BEEPS	Anketa e ndërmarrjeve mbi ambientin e biznesit

SIMBOLET KONVENCIONALE:

—	dukuria nuk ekziston
" . "	dukuria ekziston, të dhënat nuk janë në dispozicion
" ... "	zero ose afër zeros
(e)	e vlerësuar
(p)	preliminare
(r)	e reviduar

1. Parathënie

Aktiviteti ekonomik në Kosovë vazhdon të karakterizohet me zhvillime pozitive, me përjashtim të bilancit tregtar i cili karakterizohet me deficit të thellë. Sektori real i ekonomisë gjatë vitit 2011 u karakterizua me rritje pozitive prej rreth 5 përqind i nxitur kryesisht nga sektori privat. Edhe sektori publik vazhdon të ketë rolin e tij pozitiv si në kuadër të të hyrave, ashtu edhe në kuadër të shpenzimeve, sidomos atyre që kanë të bëjë me investimet kapitale. Sektori financiar vazhdon të mbetet një nga shtyllat më të rëndësishme të zhvillimit ekonomik në vend duke përkrahur bizneset dhe ekonomitë familjare me kredi, vlera aktuale e të cilave arriti në 1.7 miliardë euro. Bizneset vazhdimisht janë absorbuesi kryesor i këtyre kredive, mirëpo, edhe ndaj ekonomive familjare kreditimi vazhdimisht po shënon rritje. Njëkohësisht, sektori financiar mbetet ndër sektorët ekonomik me më së shumti investime të huaja. Kjo reflektohet nëpërmjet Investimeve të huaja direkte sipas aktivitetit ekonomik, të cilat vazhdimisht kanë pasur një pjesëmarrje prej mbi 20 përqind në gjithsej IHD-të.

Sidoqoftë, sektori i jashtëm i ekonomisë së Kosovës vazhdon të reflektojë një pozicion jo të favorshëm, sidomos në tregti. Bilanci tregtar i Kosovës vazhdimisht karakterizohet me një deficit të thellë dhe vlen cekur këtu se në shumë raste deficiti tregtar konsiderohet si tregues i nivelit të konkurrueshmërisë. Tregtia në shërbime në anën tjetër, karakterizohet vazhdimisht me zgjerim duke bërë që Kosova të ketë bilanc pozitiv dhe të jetë neto eksportues. Përkundër deficitit të vazhdueshëm në llogarinë rrjedhëse, dërgesat e emigrantëve konsiderohen ndër komponentët më të rëndësishme në ngushtimin e nivelit të këtij deficiti. Llogaria financiare e Bilancit të Pagesave të Kosovës vazhdon të jetë pozitive duke u karakterizuar me nivel të mirë investimeve të huaja direkte, gjë që e dallon Kosovën me shumicën e vendeve rajonale. Investimet tjera gjithashtu ishin pozitive në Kosovë dhe paraqiten si një kontribuues i rëndësishëm për financim në Kosovë.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës vazhdimisht informon publikun mbi zhvillimet ekonomike në vend nëpërmjet publikimeve të rregullta. Gjithashtu, edhe publikimi i statistikave për të cilat BQK është përgjegjëse kontribuon vazhdimisht në njoftimin dhe promovimin e vazhdueshëm të ambientit ekonomik si në vend, ashtu edhe në nivel ndërkombëtar. Publikimi i *Raportit të Bilancit të Pagesave* analizon zhvillimet kryesore në sektorin e jashtëm dhe ekonominë e Kosovës në përgjithësi. Në këtë numër të Raportit të Bilancit të Pagesave është përfshirë edhe një analizë tematike që për fokus ka shfrytëzimin e kapaciteteve prodhuese nga firmat në vendet e Ballkanit Perëndimor. Disa gjetje sugjerojnë se problem kryesor mbetet mungesa e konkurrueshmërisë së firmave të këtij rajoni kundrejt firmave evropiane, ndërsa reforma institucionale dhe infrastrukture janë të nevojshme që të ketë përmirësim në shfrytëzimin e kapaciteteve prodhuese nga ana e këtyre firmave. Nëpërmjet këtij publikimi BQK synon të kontribuojë vazhdimisht në debatin ekonomik në vend, por edhe në informimin e qytetarëve, profesionistëve si dhe autoritetet relevante mbi zhvillimet kryesore në ekonominë e Kosovës dhe sfidat me të cilat ajo ballafaqohet.



Gani Gërguri
Guvernator

PËRMBAJTJA:

1. Parathënie	7
2. Zhvillimet Ekonomike në Eurozonë dhe Evropën Juglindore	13
3. Zhvillimet Makroekonomike në Kosovë	14
4. Bilanci i Pagesave	16
4.1. Llogaria rrjedhëse	16
4.1.1 Mallrat dhe shërbimet	16
4.1.2 Llogaria e shërbimeve	23
4.1.3 Të ardhurat	24
4.1.4 Transferet rrjedhëse	25
4.2 Llogaria kapitale dhe financiare	26
4.2.1 Investimet e Huaja Direkte	26
4.2.2 Portfolio investimet, investimet tjera dhe asetet rezervë	29
Tema Specifike	
5. Shfrytëzimi i Kapaciteteve Prodhuese në Vendet e Ballkanit Perëndimor: Analizë bazuar në BEEPS 2009	33
Sokol Havolli dhe Albulenë Kastrati	
6. Shtojca statistikore	43

Lista e figurave:

Figura 1. Rritja reale e PBB-së-----	14
Figura 2. Indeksi i çmimeve të konsumit, importit dhe prodhimit -----	15
Figura 3. Bilanci i llogarisë rrjedhëse-----	16
Figura 4. Bilanci tregtar -----	17
Figura 5. Eksportet-----	17
Figura 6. Struktura e eksporteve -----	17
Figura 7. Importet -----	18
Figura 8. Struktura e importeve-----	18
Figura 9. Importet sipas BEC-it -----	19
Figura 10. Struktura e importeve sipas partnerëve tregtar -----	19
Figura 11. Eksportet në Serbi dhe Bosnje e Hercegovinë-----	20
Figura 12. Importet nga Serbia dhe Bosnje e Hercegovina-----	20
Figura 13. Eksportet mujore -----	21
Figura 14. Importet mujore-----	21
Figura 15. Importet e produkteve përkatëse nga Serbia-----	22
Figura 16. Importet e produkteve përkatëse nga Maqedonia-----	22
Figura 17. Importet e produkteve përkatëse nga Shqipëria-----	22
Figura 18. Struktura e eksporteve sipas partnerëve tregtarë-----	23
Figura 19. Llogaria e shërbimeve -----	24
Figura 20. Transferet rrjedhëse-----	24
Figura 21. Pranimet e dërgesave të emigrantëve -----	25
Figura 22. Llogaria financiare -----	26
Figura 23. Investimet e huaja direkte si përqindje e PBB-së -----	26
Figura 24. Struktura e IHD-ve sipas formës së investimit -----	28
Figura 25. Investimet e huaja direkte sipas sektorit ekonomik -----	28
Figura 26. Investimet e huaja direkte sipas vendit të origjinës -----	29

Lista e tabelave:

Tabela 1. Indeksi i performancës së IHD-ve-----	27
---	----

Lista e kutive:

Kutia 1. Aplikimi i masave të reciprocitetit ndaj Serbisë dhe Bosnje e Hercegovinës -----	20
Kutia 2. Përformanca e IHD-ve në Kosovë-----	27
Kutia 3. Llogaria rrjedhëse në kushte të eurozimit-----	30

2. Zhvillimet Ekonomike në Eurozonë dhe Evropën Juglindore¹

Rritja ekonomike në vendet e eurozonës është vlerësuar të jetë 1.5 përqind për vitin 2011, që paraqet një rritje më të ngadalshme në krahasim me vitin 2010. Rritja ekonomike në vendet e eurozonës kryesisht po mbështetet nga rritja e eksporteve, marrë parasysh se kërkesa nga vendet në zhvillim ka shënuar rimëkëmbje gjatë kësaj periudhe. Faktor tjetër i rëndësishëm në rritjen ekonomike në eurozonë vazhdon të jetë edhe rritja e kërkesës së brendshme. Ndërsa, ndër faktorët me ndikim negativ në aktivitetin ekonomik të eurozonës ishte rënia e besimit në ekonomi për shkak të borxhi publik të disa vendeve të eurozonës. Sidoqoftë, vendet si Gjermania dhe Franca po vërehem zhvillime pozitive për sa i përket besimit të publikut në ekonomi. Zhvillime pozitive në vendet e eurozonës janë nxitur kryesisht nga eksportet si dhe norma e ulët e interesit e cila ka nxitur kërkesën e përgjithshme në këto dy vende. Rrjedhimisht, ndër faktorët kryesor që ka ndikuar në rritjen pozitive ekonomike të eurozonës gjatë vitit 2011 paraqitet të jenë neto eksportet, ndërsa kontribut më të ulët kanë pasur investimet dhe konsumi privat.

Norma e papunësisë në vendet e eurozonës gjatë vitit 2011 ishte më e ulët në krahasim me vitin paraprak. Gjatë vitit 2011 norma e papunësisë ishte 9.9 përqind krahasuar me 10.1 në vitin 2010. Eurozona gjatë vitit 2011 u karakterizua me nivel të inflacionit prej 2.8 përqind, që tejkalon objektivin e BQE-së për të mbajtur inflacionin në rreth 2 përqind.

Borxhi publik i disa vendeve të eurozonës vazhdon të jetë faktori kryesor i cili po shkakton shqetësime mbi performancën ekonomike të vendeve të eurozonës. Borxhi publik në vendet e eurozonës arriti në 86.8 përqind të PBB-së deri në fund të vitit 2011. Deficiti buxhetor vazhdon të thellohet në disa vende të BE-së, përfshirë edhe vendet të cilat konsiderohen me probleme me borxhin. Në nivel të eurozonës, deficiti shënoi rritje deri në shtator 2011 duke arritur në 3.6 përqind të PBB-së. Greqia, Portugalia dhe Irlanda vazhdojnë të jenë vendet me problemet më të theksuara në financimin e borxhit shtetëror, por edhe me humbje të besimit mbi aftësinë paguese të borxhit nga këto shtete. Si rezultat, norma e interesit në fletëobligacionet 10 vjeçare të këtyre shteteve arriti në rreth 30 përqind për Greqinë, rreth 12 përqind për Portugalinë dhe rreth 8 përqind për Irlandën.

Vendet e Evropës Juglindore (EJL), gjatë vitit 2011 shënuan rritje ekonomike të moderuar. Në tremujorin e tretë të vitit 2011, normën më të lartë të rritjes në rajon, me 3.5 përqind, e regjistroi Mali i Zi. Po ashtu, Maqedonia, Kroacia dhe Serbia regjistruan rritje të PBB-së me normë reale prej 2.3, 0.7 dhe 0.5 përqind, respektivisht. Kontribuuesit kryesor në rritjen ekonomike në vendet e EJL-së gjatë vitit 2011 ishin investimet dhe konsumi privat. Eksportet nga vendet e EJL-së kryesisht shënuan rritje më të theksuar se importet, mirëpo, përkundër këtyre përmirësimeve, përveç Kroacisë, të gjitha vendet tjera të rajonit ballafaqohen me deficit në llogarinë rrjedhëse.

Përkundër se karakteristikë kryesore e vendeve të EJL-së gjatë kësaj periudhe ishte rritja ekonomike, llogaria rrjedhëse e këtyre vendeve gjatë vitit 2011 konsiderohet të ketë arritur nivel relativisht të lartë të deficitit si rezultat i rritjes së vazhdueshme të kërkesës së brendshme. Në anën tjetër, investimet e huaja direkte gjatë vitit 2011 janë rikuperuar, sidoqoftë niveli i tyre mbetet nën atë të para krizës së vitit 2008-2009.

Vendet e EJL-së gjatë periudhës janar-shtator 2011 shënuan rritje të konsiderueshme të çmimeve. Niveli më i lartë i inflacionit u regjistrua në Serbi (mbi 10 përqind). Vendet tjera

¹ International Monetary Fund (2011): Regional Economic Outlook, European Central Bank (2011): Monthly Bulletin, European Commission (2011): EU Candidates and Pre-Accession Countries; Economic Quarterly, Business Monitor International (2011) Emerging Europe Monitor, Bloomberg Newsletter


të rajonit kishin nivel të inflacionit prej mesatarisht 4 përqind. Gjatë kësaj periudhe, tregu i punës në vendet e EJL-së u karakterizua me rënie të lehtë të normës së papunësisë. Në Kroaci, norma e papunësisë shënoi rënie prej 1.2pp, duke qëndruar në 12.2 përqind në shtator 2011. Ngjashëm, në Mal të Zi shkalla e papunësisë u zvogëlua për 0.2pp, duke qëndruar në 11.1 përqind, dhe në Maqedoni u zvogëlua për 0.1pp dhe qëndroi në 31.2 përqind.

Gjatë vitit 2011, euro u zhvlerësua ndaj shumicës së valutave kryesore botërore, ku zhvlerësimin më të theksuar e regjistroi ndaj frankës zvicerane me 4.1 përqind (1.23 SFR/EUR), pastaj ndaj dollarit amerikan me 1.65 përqind (1.32 USD/EUR), si dhe ndaj funtës britanike me 0.7 përqind (0.84 GBR/EUR). Po ashtu, valuta euro u zhvlerësua edhe ndaj pjesës më të madhe të valutave të vendeve të EJL-së. Gjatë vitit 2011, euro u zhvlerësua ndaj lekut shqiptar, dinarit serb dhe denarit maqedon, ndërsa ndaj kunës kroate u vlerësua për 1.5 përqind.

3. Zhvillimet Makroekonomike në Kosovë

Aktiviteti ekonomik në Kosovë përkundër sfidave të shkaktuara nga luhatjet në ekonomitë rajonale dhe ekonominë globale vazhdimisht po shënon normë pozitive të rritjes. Rritja reale ekonomike gjatë vitit 2011 ishte rreth 5.0 përqind (3.9 përqind në vitin 2010). Në terma nominal, Produkti i Brendshëm Bruto (PBB) gjatë vitit 2011 tejkaloi shumë prej 4.7 miliardë euro. Gjatë vitit 2011 konsiderohet se ka pasur zhvillime pozitive në komponentët

Figura 1. Rritja reale e PBB-së



Burimi: ASK (2010), BQK (2011)

kryesor të Produktit të Brendshëm Bruto (PBB), sidomos te konsumi dhe investimet. Në anën tjetër, deficitin në bilancin e tregtisë me sektorin e jashtëm vazhdon të jetë një kontribuues negativ për rritjen ekonomike në vend. Përkundër se aktiviteti ekonomik vazhdimisht po shënon norma pozitive të rritjes, problem i vazhdueshëm për ekonominë e vendit paraqitet të jetë norma e lartë e papunësisë e cila tejkalon shifrën prej 40 përqind të fuqisë punëtore (ASK, 2009).

Konsumi si kategoria kryesore e PBB-së arriti të ketë pjesëmarrje prej rreth 107 përqind të PBB-së. Konsumi privat vazhdon të përkrahet në masë të madhe nga dërgesat e emigrantëve, por edhe nga kreditë e sistemit financiar të cilat vazhduan trendin e rritjes. Struktura e përgjithshme e konsumit dominohet nga konsumi i sektorit privat, ndërsa pjesëmarrja e konsumit publik kishte nivel të ngjashëm me vitin paraprak. Kreditimi i nga sektori bankar vazhdon të jetë njëra ndër format e rëndësishme të financimit në ekonominë e Kosovës. Kreditë e lëshuara nga sistemi bankar në vend deri në fund të shtatorit 2011 arriti në 1.65 miliardë euro, që paraqet një normë të rritjes prej 16.7 përqind. Nga gjithsej kreditë e lëshuara në ekonomi, 30.1 përqind janë kredi të lëshuara për ekonomitë familjare, ndërsa pjesa tjetër për ndërmarrjet. Kreditimi i ekonomive familjare vazhdoi trendin e rritjes. Si njëri ndër burimet e rëndësishme të financimit të konsumit, deri në shtator 2011


kreditë ndaj ekonomive familjare shënuan rritje vjetore prej 18.1 përqind duke arritur vlerën prej 499.4 milionë euro. Po ashtu, dërgesat e emigrantëve, si njëri ndër burimet kryesore për financimin e konsumit në Kosovë, deri në shtator 2011 shënuan rritje vjetore prej rreth 4 përqind duke arritur vlerën 393.3 milionë euro. Në anën tjetër, shpenzimet qeveritare për konsum të mallrave dhe shërbimeve shënuan rënie, duke ndikuar kështu negativisht në konsumin e përgjithshëm. Sidoqoftë, rritja e pagave për shërbyesit civil ka ndikuar pozitivisht në konsumin e sektorit privat në vend.

Rritje kanë vazhduar të shënojnë edhe investimet, ndërsa mbështetës të rëndësishëm të aktivitetit investiv vazhdojnë të jenë kreditë e sektorit bankar, investimet e huaja direkte si dhe investimet publike. Investimet përbëjnë rreth 35 përqind të PBB-së. Kreditimi i ndërmarrjeve deri në shtator 2011 kishte pjesëmarrje prej 67.8 përqind në gjithsej kreditë ndërsa vlera e tyre arriti në 1.1 miliardë euro (rritje prej 14.4 përqind). Investimet e Huaja Direkte (IHD) shënuan rritje të konsiderueshme deri në shtator 2011 duke arritur vlerën prej 292.7 milionë euro. Investimet publike gjatë periudhës janar-shtator 2011 paraqesin gjithashtu një komponentë mjaft të rëndësishme në kuadër të strukturës së përgjithshme të investimeve në Kosovo. Vlera e investimeve publike gjatë kësaj periudhe arriti në 324.7 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 39 përqind.

Lëvizjet e çmimeve në Kosovë në masën më të madhe shkaktohen nga çmimet e importit. Pjesa e parë e vitit 2011 u karakterizua me presione inflacioniste në rritje të cilat u zbutën në periudhën korrik-shtator të vitit 2011. Indeksi i Çmimeve të Konsumit (*angl. Consumer Price Index: CPI*) në Kosovë për periudhën janar-shtator 2011 shënoi rritje mesatare vjetore prej mbi 8 përqind krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak, ndërsa në shtator ndryshimi vjetor ishte 4.8 përqind (Figura 2). Kontribuues kryesor në rritjen e çmimeve në Kosovë ishin çmimet e drithërave dhe karburanteve, të cilat gjithashtu paraqiten si kategori me peshë relativisht të lartë në gjithsej importet. Se çmimet e produkteve të importuara, shprehur përmes Indeksit të Çmimeve të Importit (*angl. Imports Price Index: IPI*), kanë ndikim të rëndësishëm në nivelin e përgjithshëm të CPI. Deri në shtator 2011, IPI shënoi rritje vjetore prej 10.4 përqind. Ndërsa, çmimet e produkteve të prodhuara në Kosovë, shprehur përmes Indeksit të Çmimeve të Prodhimit (*angl. Producer Price Index: PPI*), shënuan rritje vjetore prej mesatarisht 7.3 përqind.

Norma relativisht e lartë e inflacionit në Kosovë gjatë vitit 2011 është reflektuar edhe në normën reale efektive të këmbimit (*angl. Real Effective Exchange Rate: REER*), e cila gjatë periudhës janar-shtator 2011 është revaluuar ndaj vendeve të BE-së dhe CEFTA-s për 5.2 përqind, përkatësisht 3.2 përqind. Revaluimi i REER të Kosovës kundrejt partnerëve tregtarë sugjeron se eksportet e Kosovës janë bërë për një masë më të shtrenjta për blerësit e jashtëm, gjë e cila ka implikime negative për konkurrueshmërinë e mallrave të Kosovës në tregjet e jashtme.

Figura 2. Indeksi i çmimit të konsumit, importit dhe prodhimit



Burimi: ESK (2011)

Figura 2) Kontribuues kryesor në rritjen e çmimeve në Kosovë ishin çmimet e drithërave dhe karburanteve, të cilat gjithashtu paraqiten si kategori me peshë relativisht të lartë në gjithsej importet. Se çmimet e produkteve të importuara, shprehur përmes Indeksit të Çmimeve të Importit (*angl. Imports Price Index: IPI*), kanë ndikim të rëndësishëm në nivelin e përgjithshëm të CPI. Deri në shtator 2011, IPI shënoi rritje vjetore prej 10.4 përqind. Ndërsa, çmimet e produkteve të prodhuara në Kosovë, shprehur përmes Indeksit të Çmimeve të Prodhimit (*angl. Producer Price Index: PPI*), shënuan rritje vjetore prej mesatarisht 7.3 përqind.

Norma relativisht e lartë e inflacionit në Kosovë gjatë vitit 2011 është reflektuar edhe në normën reale efektive të këmbimit (*angl. Real Effective Exchange Rate: REER*), e cila gjatë periudhës janar-shtator 2011 është revaluuar ndaj vendeve të BE-së dhe CEFTA-s për 5.2 përqind, përkatësisht 3.2 përqind. Revaluimi i REER të Kosovës kundrejt partnerëve tregtarë sugjeron se eksportet e Kosovës janë bërë për një masë më të shtrenjta për blerësit e jashtëm, gjë e cila ka implikime negative për konkurrueshmërinë e mallrave të Kosovës në tregjet e jashtme.

4. Bilanci i Pagesave në Kosovë

Pozicioni i jashtëm i Kosovës gjatë periudhës janar-shtator 2011 u karakterizua me rritje të deficitit të llogarisë rrjedhëse. Deficiti në tregtinë e mallrave paraqitet të jetë kontribuuesi kryesor në thellimin e deficitit të llogarisë rrjedhëse. Edhe pse eksportet e mallrave gjatë kësaj periudhe shënuan rritje, niveli i lartë i importeve, dhe rritja e tyre ndikuan që deficitin tregtar të vazhdojë të rritet. Në anën tjetër, tregtia e shërbimeve kishte bilanc pozitiv, u dyfisha krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Të ardhurat dhe transferet deri në shtator 2011 shënuan rritje të bilancit pozitiv, i cili të karakterizojë këtë llogari, duke koontribuar kështu në ngushtimin e deficitit të llogarisë rrjedhëse. Edhe llogaria kapitale dhe financiare deri në shtator të vitit 2011 shënoi bilanc pozitiv, ndërsa nxitësit kryesor të këtij bilanci vazhdimisht janë investimet e huaja direkte si dhe investimet tjera. Gjatë kësaj periudhe, investimet e huaja direkte shënuan rritje prej 22.9 përqind.

4.1. Llogaria rrjedhëse


Deri në shtator 2011, deficitin e llogarisë rrjedhëse të Kosovës arriti në 588.4 milionë euro, dhe shënoi një rritje prej 7.2 përqind, që është më e ulët krahasuar me rritjen e shënuar në vitin paraprak (17.7 përqind). Raporti ndërmjet deficitit të llogarisë rrjedhëse dhe PBB-së në shtator 2011 arriti në 16.8 përqind krahasuar me 17.4 përqind në shtator të vitit 2010. Në rritjen e bilancit negativ të llogarisë rrjedhëse kryesisht ka ndikuar bilanci i lartë negativ në

llogarinë e tregtisë së mallrave (deficitin tregtar), i cili ka vazhduar të rritet edhe gjatë vitit 2011 (Figura 3). Në zbutjen e deficitit të llogarisë rrjedhëse, në veçanti ka kontribuar bilanci pozitiv i shërbimeve tregtare, i cili deri në shtator 2011 dyfishoi vëllimin e tij. Kategoria kryesore në kuadër të pranimeve në llogarinë rrjedhëse përfaqësohet nga transferet rrjedhëse, të cilat në shtator 2011 kishin pjesëmarrje prej 47.6 përqind të gjithëj pranimeve në këtë llogari. Ndërsa, pagesat nga llogaria rrjedhëse kryesisht janë të destinuara për blerjen e mallrave dhe përbëjnë 77.6 përqind të gjithëj pagesave.

4.1.1 Mallrat dhe shërbimet

Rritja e vazhdueshme e shkëmbimeve tregtare ndërmjet Kosovës dhe vendeve tjera ka ndikuar që shkalla e hapjes tregtare (e matur si shuma e eksporteve dhe importeve në raport me PBB-në) të shënojë trend rritës gjatë viteve të fundit (57.4 përqind deri në shtator 2011, 55.9 përqind deri në shtator 2010). Varësia e lartë e ekonomisë së Kosovës në importe ka bërë që niveli i importeve në vend të jetë dukshëm më i lartë sesa niveli i eksporteve. Rrjedhimisht, mbulueshmëria e importeve me eksporte vazhdon të qëndrojë në një nivel relativisht të ulët (13.7 përqind), nivel ky që nuk ndryshoi shumë nga periudha e njëjtë e vitit të kaluar (Figura 4). Deri në shtator 2011, bilanci tregtar i Kosovës shënoi deficit prej 1.5 miliardë euro (43.6 përqind e PBB-së), që paraqet një rritje vjetore prej 13.4 përqind.

Figura 3. Bilanci i llogarisë rrjedhëse, në milionë euro




Eksportet e Kosovës, deri në shtator 2011 arritën vlerën prej 241.6 milionë euro dhe shënuan rritje vjetore prej 12.7 përqind. Prej vitit 2009, kur eksportet e Kosovës shënuan rënie, si pasojë e implikimeve të krizës globale financiare, në dy vitet e fundit eksportet kanë vazhduar me trend pozitiv (Figura 5). Rritja mesatare e vlerës së eksporteve të Kosovës në katër vitet e fundit ishte rreth 30 milionë euro, ndërsa në terma relativë mesatarisht rreth 27 përqind në vit.

Në strukturën e eksporteve të Kosovës, metalet bazë vazhdojnë të jenë kategoria dominuese, me pjesëmarrje prej 62.1 përqind (62.9 përqind në shtator 2010), (Figura 6). Pjesëmarrja relativisht e lartë e metaleve bazë tregon për një shkallë të lartë të koncentrimit të kësaj kategorie në gjithsej eksportet e Kosovës. Për rrjedhojë, performanca e përgjithshme e eksporteve të vendit mund të tregohet mjaft e ndjeshme, ndaj

ndryshimeve në kërkesën e jashtme për këtë kategori të produkteve. Metalet bazë deri në shtator 2011 arritën vlerën prej 177.1 milionë euro dhe shënuan rritje vjetore prej 11.3 përqind, duke përfaqësuar kështu kontribuuesin kryesor në rritjen e përgjithshme të eksporteve. Produktet minerale paraqesin kategorinë e dytë më të madhe, me pjesëmarrje prej 14 përqind në gjithsej eksportet e Kosovës. Në eksportet e produkteve minerale


kryesisht bëjnë pjesë mineralet tokësore dhe xehet. Produktet minerale deri në shtator 2011 arritën vlerën prej 32.7 milionë euro dhe shënuan rritje vjetore prej 36.4 përqind. Kategori tjera të rëndësishme në kuadër të strukturës së eksporteve janë edhe makineritë, ushqimi e pijet, perimet, plastika dhe lëkura. Këto kategori të eksporteve deri në shtator 2011, morën pjesë me nga 3.8 përqind në gjithsej eksportet e Kosovës.

Figura 4. Bilanci tregtar, në milionë euro




Burimi: BQK (2011)

Figura 5. Eksportet, në milionë euro



Burimi: BQK (2011)

Figura 6. Struktura eksporteve




Burimi: BQK (2011)

Deri në shtator 2011, importet e Kosovës arritën vlerën prej 1.76 miliardë euro dhe shënuan rritje vjetore prej 13.4 përqind (Figura 7). Megjithatë, rritja nominale prej 13.4 përqind kryesisht reflekton rritjen e çmimeve të produkteve të importuara, përkatësisht rritjen e çmimeve të naftës. Ndërsa, rritja reale vjetore e importeve deri në shtator 2011 ishte vetëm rreth 4 përqind.


Struktura e importeve të Kosovës vazhdon të jetë e ngjashme me vitet paraprake. Kategoria më e madhe e importeve vazhdon të përfaqësohet nga produktet minerale, të cilat deri në shtator 2011 rritën pjesëmarrjen e tyre në 21.5 përqind, krahasuar me 19.6 përqind në shtator 2010 (Figura 8). Në kuadër të produkteve minerale, Kosova më së shumti importon karburante dhe produkte të qeramikës. Vlera e importeve të produkteve minerale, deri në shtator 2011, ishte 379.1 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 24.6 përqind. Kategoria e dytë për nga pjesëmarrja në gjithsej importet e Kosovës përbëhet nga produktet e ushqimit dhe pijeve të cilat shënuan një pjesëmarrje prej 12.2 përqind, pasuar nga makineritë dhe pajisjet të cilat u përfaqësuan me pjesëmarrje prej 10.1 përqind në gjithsej importet e Kosovës (13.4 përqind deri në shtator 2010). Makineritë dhe pajisjet, deri në shtator 2011 arritën vlerën prej 178.4 milionë euro, që paraqet një rënie vjetore prej 14.2 përqind. Një kategori tjetër e rëndësishme e produkteve të importuara në Kosovë përbëhet nga metalet bazë, të cilat regjistruan një pjesëmarrje prej 9.4 përqind (8.9 përqind deri në shtator 2010). Importi i produkteve ushqimore, deri në shtator 2011, u përfaqësua me 12.2 përqind gjithsej në strukturën e importeve, duke mbajtur një nivel të ngjashëm të pjesëmarrjes me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Megjithatë, vlera e produkteve

Figura 7. Importet, në milionë euro




Burimi: BQK (2011)

Figura 8. Struktura e importeve, në përqindje



Burimi: BQK (2011)

Figura 9. Importet sipas BEC-it



Burimi: BQK (2011)

ushqimore të importuara shënoi rritje vjetore prej 12 përqind, gjë që mund të shërbejë si tregues i rritjes së konsumit në vend.


Struktura e produkteve të importuara sipas Kategorive Kryesore Ekonomike (angl. Broad Economic Categories: BEC), apo struktura e këtyre produkteve sipas qëllimit të përdorimit, deri në shtator 2011 ishte e ngjashme me vitet paraprahe. Produktet e ndërmjetme ishin kategoria me kontributin më të madh në rritjen e përgjithshme të importeve, duke kontribuar me 14.2pp. Po ashtu, në rritjen e importeve kontribuan edhe mallrat e konsumit, mirëpo në një nivel më të ulët (4.1pp). Në anën tjetër, mallrat kapitale kontribuan negativisht në rritjen e importeve me rreth 0.9pp. Kategoria më e madhe e importeve, bazuar në klasifikimin sipas BEC, përfaqësohet nga produktet e ndërmjetme (53.8 përqind), të cilat deri në tremujorin e tretë 2011 arritën vlerën prej 946.8 milionë euro dhe shënuan rritje vjetore prej 30.3 përqind (Figura 9). Sipas klasifikimit BEC, kategoria e dytë me pjesëmarrje prej 30.9 përqind përfaqësohet nga mallrat e konsumit. Mallrat e konsumit, deri në shtator 2011 arritën vlerën prej 543.6 milionë euro dhe shënuan rritje vjetore prej 13.2 përqind. Përkundër trendit rritës në vlerë, mallrat e konsumit kanë ruajtur pjesëmarrje të ngjashme gjatë katër viteve të fundit (rreth 31 përqind të gjithsej importeve). Rritja e mallrave të ndërmjetme dhe mallrave të konsumit mund të jetë një tregues i rritjes së kërkesës në vend gjatë periudhës janar-shtator 2011. Mallrat kapitale deri në tremujorin e tretë të vitit 2011 arritën vlerën prej 141.8 milionë euro. Në dy vitet e fundit, mallrat kapitale kanë shënuar trend negativ të rritjes vjetore (8.7 përqind rënie vjetore deri në shtator 2011, 12.3 përqind rënie vjetore deri në shtator 2010). Po ashtu, gjatë dy viteve të fundit pjesëmarrja e mallrave kapitale në gjithsej importet e Kosovës është zvogëluar për 2pp në vit. Pjesëmarrja e ulët dhe në rënie e importit të mallrave kapitale mund të shërbejë si tregues i aktivitetit të ulët prodhues dhe investues në vend. Në anën tjetër, importi relativisht i lartë i mallrave të ndërmjetme tregon se aktiviteti prodhues në vend mbështetet mjaft shumë në importimin e lëndës së parë nga jashtë.

Sa i përket strukturës importeve sipas partnerëve tregtarë, vendet e BE-së dhe vendet anëtare të CEFTA-s përbëjnë vendet prej nga Kosova importon pjesën më të madhe të mallrave. Në tremujorin e tretë të vitit 2011, Kosova importoi rreth 37 përqind të gjithsej importeve nga vendet e BE-së, si dhe 37 përqind të gjithsej importeve edhe nga vendet e CEFTA-s (Figura 10).

Në kuadër të vendeve të BE-së,

Gjermania paraqet vendin nga i cili Kosova importon më së shumti, me pjesëmarrje prej 11.6 përqind në gjithsej importet e Kosovës (13 përqind deri në shtator 2010). Importet nga Gjermania deri në shtator 2011 kapën vlerën prej 204.6 milionë euro dhe shënuan rritje vjetore prej 1.3 përqind. Pjesa më e madhe e mallrave të importuara nga Gjermania përbëhet nga mjetet e transportit. Pas Gjermanisë radhitet Italia, importet e së cilës gjithashtu po shënojnë trend rritës (5.9 përqind në shtator 2011, 4.4 përqind në shtator 2010). Importet e Kosovës nga Italia shënuan vlerën prej 103.8 milionë euro dhe përfaqësuan rreth 6 përqind të gjithsej importeve të Kosovës. Në periudhën e njëjtë të vitit

Figura 10. Struktura e importeve sipas partnerëve tregtarë



Burimi: BQK (2011)


të kaluar, Greqia ishte vendi i dytë për nga pjesëmarrja në gjithsej importet e vendit, megjithatë si rrjedhojë e rritjes së importeve nga Italia, importet nga Greqia humbën në pjesëmarrje të gjithsej importeve të Kosovës, nga 5.9 përqind në shtator 2010 në 4.4 përqind në shtator 2011, duke u radhitur kështu si vendi i tretë për nga madhësia e importeve në Kosovë.

Importet nga vendet e CEFTA-s shënuan rritje vjetore prej 11 përqind. Prej vendeve të CEFTA-s, deri në shtator 2011, Kosova më së shumti ka importuar nga Maqedonia (15.9 përqind) dhe atë më së shumti produkte minerale. Deri në shtator 2011, importet nga Maqedonia gjithashtu shënuan një rritje vjetore më të shpejtuar prej 20.3 përqind, krahasuar me 6 përqind sa ishte rritja vjetore e një viti më parë. Në anën tjetër, gjatë periudhës janar-shtator 2011 vërehet një ngadalësim më i ndjeshëm i importeve nga Serbia, ku rritja vjetore ishte 3.4 përqind, krahasuar me rritjen vjetore prej 23.4 përqind në shtator të vitit 2010. Rritja e importeve nga Maqedonia në njërin anë, si dhe ngadalësimi i importeve nga Serbia në anën tjetër, kanë ardhur si pasojë e masave të reciprocitetit të vendosura ndaj mallrave të Serbisë gjatë periudhës gusht-shtator 2011. Shqipëria paraqet vendin e tretë me radhë për nga vlera e importeve në Kosovë. Importet nga Shqipëria kapën vlerën prej 66.9 milionë euro dhe shënuan rritje vjetore prej 25.8 përqind (shih Kutia 1).

Kutia 1. Aplikimi i masave të reciprocitetit ndaj Serbisë dhe Bosnje e Hercegovinës


Pas shpalljes së pavarësisë në shkurt të vitit 2008, Republika e Kosovës ndërroi vulat e doganave nga “Doganat e UNMIK-ut” në “Doganat e Kosovës”. Si rezultat i ndërrimit të vulave, Serbia dhe Bosnje e Hercegovina që nga 4 dhjetori i vitit 2008 bllokuan si eksportin ashtu edhe shfrytëzimin e territorit të tyre për transit të produkteve kosovare. Rrjedhimisht, që nga dhjetori i vitit 2008, eksporti i Kosovës në këto dy vende shënoi rënie drastike (Figura 11).

Figura 11. Eksportet në Serbi dhe Bosnje e Hercegovinë, në milionë euro



Burimi: BQK (2011)


Figura 12. Importet nga Serbia dhe Bosnje e Hercegovina, në milionë euro



Burimi: BQK (2011)


Eksportet e Kosovës në Serbi dhe Bosnje e Hercegovinë edhe para anëtarësimit të Kosovës në CEFTA kanë pasur bazë të ulët. Për shembull, gjatë gjashtë viteve të fundit Kosova ka eksportuar në Serbi vetëm rreth 5.2 përqind të gjithsej eksporteve. Ngjashëm qëndron situata edhe me eksportet në Bosnje e Hercegovinë, ku gjatë gjashtë viteve të fundit Kosova ka eksportuar vetëm 2.1 përqind të gjithsej eksporteve. Prej momentit të ndërrimit të vulave doganore nga Kosova (prej vitit 2008 deri në vitin 2011), si pasojë e bllokadave tregtare që këto dy shtete kanë aplikuar ndaj produkteve kosovare, eksportet në Serbi kanë rënë në 1.8 përqind ndërsa pjesëmarrja e eksporteve të Kosovës në Bosnje e Hercegovinë u zvogëluar në 0.5 përqind të gjithsej eksporteve të Kosovës.

Figura 13. Eksportet mujore, në milionë euro



Burimi: BQK (2011)

Figura 14. Importet mujore, në milionë euro



Burimi: BQK (2011)

Ndërkohë, ndryshe nga vlera relativisht e ulët e eksporteve të Kosovës në këto dy vende, importet nga Serbia dhe Bosnja e Hercegovina janë dukshëm më të larta (Figura 12). Në gjashtë vitet e fundit Kosova ka importuar nga Serbia mesatarisht 12.1 përqind të gjithsej importeve. Ndërsa, edhe pas shpalljes së pavarësisë (prej vitit 2008 deri në vitin 2011), importet nga Serbia kanë vazhduar me një nivel të lartë dhe nuk kanë ndryshuar shumë pjesëmarrjen në gjithsej importet e Kosovës (rreth 11 përqind të gjithsej importeve). Gjithashtu, importet nga Bosnja e Hercegovina në gjashtë vitet e fundit ishin mesatarisht 2.7 përqind e gjithsej importeve, ndërsa pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës, pjesëmarrja e importeve të këtij vendi u rrit për 0.9pp.

Në kundërpërgjigje ndaj bllokadës së mallrave kosovare nga ana e Serbisë dhe Bosnje e Hercegovinës, në korrik të vitit 2011, Qeveria e Republikës së Kosovës mori vendimin për vendosjen e masave të reciprocitetit tregtar me Serbinë dhe Bosnje e Hercegovinën. Sipas këtyre masave, u mor vendimi që të mos njihen vulat e doganore të Serbisë si dhe bllokimi i plotë i mallrave që përmbajnë këto vula. Po ashtu, Qeveria e Republikës së Kosovës mori vendimin që të mos njihen vulat e doganore të Bosnje e Hercegovinës si dhe u vendos taksa doganore prej 10 përqind në mallrat që përmbanin vulën doganore të Bosnje e Hercegovinës.² Aplikimi i masave të reciprocitetit nga ana e Kosovës që filloi në fund të korrikut të vitit 2011, dhe vazhdoi në muajin vijues, u reflektua në rënie të menjëhershme si të eksporteve të Kosovës ashtu edhe në importet nga Serbia e Bosnja e Hercegovina (Figura 13 dhe Figura 14). Megjithatë, në muajin korrik pati rritje të përnjëhershme të eksportit të energjisë elektrike në Serbi (Figura 13). Trendi i rritjes së importeve nga Serbia një muaj pas aplikimit të masave të reciprocitetit u ngadalësua ndjeshëm në 2.9 përqind (24.1 përqind rritje mujore në qershor 2011). Përkundër masave të reciprocitetit, një masë relativisht e vogël e mallrave nga Serbia megjithatë kanë vazhduar të hyjnë në Kosovë.

Megjithatë, këto ishin mallrat, dokumentet e së cilave janë procesuar para marrjes së vendimit për reciprocitet tregtar. Po ashtu, si pasojë e aplikimit të taksës doganore prej 10 përqind në mallrat me vulat doganore të Bosnje e Hercegovinës, edhe vlera e mallrave të importuara nga Bosnja e Hercegovina shënoi trend më të ngadalësuar të rritjes prej 17.2 përqind në gusht 2011 (29.4 përqind rritje mujore në qershor 2011).

² Në vendimin për parimin e reciprocitetit në marrëdhëniet tregtare thuhet: 'Nuk njihen vulat doganore dhe të Administratës Tatimore të Republikës së Serbisë. Ndalohet importi i të gjitha mallrave të përcjella me dokumente që përmbajnë këto vula. Nuk njihen vulat doganore të Republikës së Bosnje e Hercegovinës. Vendoset taksa doganore prej 10 përqind në mallrat e përcjella me dokumente që përmbajnë këtë vullë'.

Në anën tjetër, gjatë kohës së zbatimit të masave të reciprocitetit tregtar nga ana e Kosovës, importet nga Maqedonia dominuan strukturën e importeve kosovare (16 përqind të gjithsej importeve), ndërsa importet nga Shqipëria dhe Kroacia thuhet se u dyfishuan nga tremujori i dytë në tremujorin e tretë të vitit 2011. Sa i përket importit në bazë të produkteve, prej vendeve anëtare të CEFTA-s, Kosova më së shumti importon produkte minerale, ushqim dhe perime. Me fillimin e aplikimit të masave të reciprocitetit vërehet rënia e importeve të këtyre produkteve nga Serbia dhe në të njëjtën kohë, rritja e importit të këtyre produkteve nga Maqedonia dhe Shqipëria (Figura 15, 16, 17). Përkundër aplikimit të masave të reciprocitetit ndaj Serbisë dhe Bosnje e Hercegovinës, importet në Kosovë shënuan rritje si mujore (20.3 përqind në gusht 2011), ashtu edhe rritje tremujore (61 përqind në tremujorin e tretë 2011). Ndalimi i importeve nga Serbia e Bosnje e Hercegovina në masë të madhe u zëvendësua me importe nga Maqedonia dhe Shqipëria. Prandaj, mund të thuhet se masat e reciprocitetit nuk afektuan gjithsej vlerën e importeve, por shkaktuan efektin e zëvendësimit të produkteve të importuara nga Serbia dhe Bosnja e Hercegovina në importimin e produkteve nga Maqedonia dhe Shqipëria.

Në muajin shtator të vitit 2011, u arrit marrëveshja mes Kosovës dhe Serbisë, përmes së cilës Serbia pranoi vulat e Doganave të Kosovës. Pas saj edhe Bosnja e Hercegovina njohu vulat e Doganave të Kosovës. Rrjedhimisht edhe Kosova filloi njohjen e vulave të Doganave të Serbisë dhe Bosnje e Hercegovinës. Ky vendim shënoi fundin e masave të reciprocitetit tregtar që Kosova aplikoi për mallrat e Serbisë dhe Bosnje e Hercegovinës.

Figura 15. Importet e produkteve përkatëse nga Serbia, në milionë euro




Figura 16. Importet e produkteve përkatëse nga Maqedonia, në milionë euro





Figura 17. Importet e produkteve përkatëse nga Shqipëria, në milionë euro



Vendet e BE-së dhe vendet anëtare të CEFTA-s gjithashtu vazhdojnë të përfaqësojnë partnerët kryesorë tregtarë të Kosovës për eksporte, me pjesëmarrje prej 43.2, përkatësisht 26.2 përqind të gjithsej eksporteve (Figura 18). Në kuadër të vendeve të BE-së, në tri vitet e fundit Italia paraqet destinimin kryesor të eksporteve të Kosovës, me pjesëmarrje prej 26.8 përqind në gjithsej eksportet e Kosovës. Deri në shtator 2011,


eksportet drejt Italisë arritën vlerën prej 64.9 milionë euro dhe shënuan rritje vjetore prej 7.3 përqind. Produktet e eksportuara në Itali janë kryesisht xehe të nikelit. Vendi i dytë me radhë për nga pjesëmarrja në gjithsej eksportet e Kosovës është Gjermania, në të cilën deri në shtator 2011 eksportet e Kosovës pothuajse u dyfishuan dhe arritën vlerën prej 14.6 milionë euro. Vendet tjera të BE-së, si Austria dhe Belgjika, gjithashtu kanë pjesëmarrje të rëndësishme në eksportet e Kosovës. Vlera e mallrave të eksportuara nga Kosova në Austri në shtator 2011 ishte 4.9 milionë euro, që paraqet vlerë të ngjashme me atë të një viti më parë, ndërsa eksportet drejt Belgjikës u zvogëluan nga 7.5 milionë në shtator 2010 në 4.7 milionë në shtator 2011.

Eksportet drejt vendeve anëtare të CEFTA-s u rritën si në vlerë (18.3 përqind rritje vjetore) ashtu edhe në pjesëmarrje ndaj gjithsej eksporteve (1.2pp). Shpërndarja gjeografike e eksporteve të Kosovës në vendet anëtare të CEFTA-s mbetet e ngjashme me vitet e mëparshme, ku Shqipëria dhe Maqedonia paraqesin destinacionet kryesore me pjesëmarrje prej 10.6 përkatësisht 9.8 përqind në gjithsej eksportet e Kosovës. Deri në shtator 2011, vlera e eksporteve të Kosovës drejt Shqipërisë nuk ndryshoi shumë nga periudha e njëjtë e vitit të kaluar (25.6 milionë euro), ndërsa vlera e eksporteve drejt Maqedonisë arriti në 23.8 milionë euro dhe shënoi rritje vjetore prej 25.1 përqind. Vlera e eksporteve të Kosovës drejt Serbisë dhe Bosnje e Hercegovinës është relativisht e ulët, prej 6.2 milionë euro, përkatësisht 0.5 milionë euro. Eksportet drejt Bosnjës dhe Hercegovinës po tregojnë një trend rënës, gjë që reflekton pengesat tregtare që ky vend aplikon ndaj mallrave të Kosovës. Ndërsa, përkundër pengesave tregtare që Serbia ka aplikuar ndaj Kosovës, eksportet në këtë vend janë më se dyfishuar nga viti i kaluar, megjithatë baza e këtyre eksporteve mbetet relativisht e ulët (6.2 milionë euro), (shih Kutia 1).

4.1.2 Llogaria shërbimeve

Llogaria e tregtisë së shërbimeve deri në shtator 2011 u karakterizua me bilanc pozitiv prej 116.3 milionë euro, krahasuar me 55.6 milionë euro në shtator 2010 (Figura 19). Rritja e bilancit pozitiv të kësaj llogarie reflekton rritjen më të shpejtë të të hyrave nga shitja e shërbimeve për jorezidentët, krahasuar me rritjen e pagesave për shërbimet e blera jashtë vendit nga rezidentët kosovarë. Më konkretisht, bilanci pozitiv në periudhën janar-shtator 2011 reflekton në radhë të parë rritjen e të hyrave nga shërbimet e komunikimit dhe shërbimet tjera biznesore.


Figura 18. Struktura e eksporteve sipas partnerëve tregtarë



Burimi: BQK (2011)

Të hyrat nga shërbimet e udhëtimit shënuan rritje vjetore prej 18.9 përqind, ndërsa pagesat për këto shërbime u zvogëluan për 11 përqind. Si rrjedhojë, kjo kategori shënoi bilanc pozitiv prej 118.1 milionë euro. Në të hyrat nga shërbimet e udhëtimit kryesisht bëjnë pjesë udhëtimet personale. Në të njëjtën kohë, të hyrat nga shërbimet e komunikimit u rritën për 34.4 përqind, përderisa pagesat për shërbimet e komunikimit u zvogëluan për rreth 76 përqind. Rritja më e shpejtë e të hyrave të shërbimeve të komunikimit dhe zvogëlimi i pagesave për këto shërbime bëri që deri në shtator 2011 bilanci i kësaj llogarie të arrijë në 49.6 milionë euro (37.7 milionë euro deri në shtator 2010). Shërbimet tjera që shënuan bilanc pozitiv gjatë periudhës janar-shtator 2011 ishin edhe shërbimet qeveritare dhe shërbimet kulturore e personale. Në anën tjetër, të gjitha kategoritë tjera të shërbimeve, si shërbimet tjera biznesore, të sigurimit, etj. përmbyllën këtë periudhë me bilanc negativ.

Figura 19. Llogaria e shërbimeve, në milionë euro




Burimi: BQK (2011)

4.1.3 Të ardhurat

Deri në shtator 2011, si rrjedhojë e realizimit të të hyrave në vlerë prej 183.8 milionë euro dhe pagesave në vlerë prej 102.3 milionë euro, llogaria e të ardhurave shënoi bilanc pozitiv prej 81.5 milionë euro. Ndryshe nga periudha e njëjtë e vitit të kaluar kur bilanci i të ardhurave kishte shënuar rënie vjetore prej 9.6 përqind, në shtator të vitit 2011, ky bilanc kaloi në normë pozitive të rritjes prej 25.7 përqind. Ky ndryshim erdhi si rrjedhojë e rritjes prej 32.7 përqind të të hyrave në llogarinë e të ardhurave, krahasuar me rritjen prej 1.7 përqind një vit më parë. Rritja e pranimeve nga të ardhurat në periudhën raportuese u shkaktua kryesisht nga rritja e të hyrave nga kompenzimi i punëtorëve kosovarë jashtë vendit për 28.9 përqind (0.8 përqind rritje deri në shtator 2010)³. Njëherit, të hyrat nga kompenzimi i punëtorëve paraqesin edhe kategorinë dominuese në llogarinë e të ardhurave (91.9 përqind), duke shënuar vlerën prej 168.9 milionë euro në shtator 2011. Pjesa më e madhe e të hyrave nga kompenzimi i punëtorëve në periudhën janar-shtator 2011 përbëhet nga të ardhurat e punëtorëve kosovarë në Afganistan e Irak, si dhe nga personeli vendor i punësuar në

Figura 20. Transferet rrjedhëse, në milionë euro



Burimi: BQK (2011)

³ Kompenzimi i punëtorëve përfshin pagat, mëditjet dhe beneficionet tjera ekonomike të pranuar nga punëtorët kosovarë jashtë për punë sezonale ose afatshkurtër (deri në një vit).

KFOR. Rritje shënoi edhe kategoria e të ardhurave nga investimet, e cila dyfishoi vlerën duke arritur në 14.9 milionë euro në shtator 2011. Kjo rritje kryesisht erdhi si rrjedhojë e rritjes së të ardhurave nga interesi në depozitat e mbajtura jashtë vendit nga bankat komerciale që operojnë në Kosovë.

4.1.4 Transferet rrjedhëse


Një nga kategoritë më të rëndësishme të bilancit të pagesave, e cila në vazhdimësi ka kontribuar në ngushtimin e deficitit të llogarisë rrjedhëse, janë edhe transferet rrjedhëse. Kjo për arsye se llogaria rrjedhëse në vazhdimësi është karakterizuar me bilanc pozitiv. Deri në shtator 2011, bilanci i llogarisë rrjedhëse arriti në 687.3 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 11 përqind (Figura 20). Transferet rrjedhëse përbëhen nga transferet

qeveritare (33.3 përqind) dhe transferet e sektorit privat (66.7 përqind). Transferet e qeverisë qendrore deri në shtator 2011, arritën vlerën prej 428.2 milionë euro dhe shënuan rritje vjetore prej 11.3 përqind, që tregon për ngadalësim të rritjes në krahasim me shtator 2010 kur këto transfere shënuan rritje vjetore prej rreth 78 përqind.⁴ Në kuadër të transfereve rrjedhëse qeveritare kryesisht hyjnë transferet e donatorëve, EULEX-it dhe UNMIK-ut.

Në anën tjetër, dërgesat e emigrantëve përfaqësojnë pjesën më të madhe të transfereve rrjedhëse të sektorit privat (mbi 40 përqind të gjithsej këtyre transfereve). Bilanci i dërgesave të emigrantëve gjatë nëntë muajve të parë të vitit 2011 arriti në 315.8 milionë euro, krahasuar me 306.4 milionë euro në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar (3.1 përqind rritje vjetore në shtator 2011; 4.9 përqind në shtator 2010). Deri në shtator 2011, Kosova ka pranuar 393.3 milionë euro dërgesa të emigrantëve kosovarë në ekonominë e Kosovës (375.0 milionë euro në shtator 2010), ndërsa dërgesat e emigrantëve jorezidentë që veprojnë në Kosovë drejtë vendeve tjera shënuan vlerën prej 77.4 milionë euro (68.5 milionë euro në shtator 2010), (Figura 21).

Pjesa më e madhe e dërgesave të emigrantëve të pranuar në Kosovë vijnë nga vendet anëtare të BE-së, si Gjermania (34 përqind), Zvicra (23 përqind), Austria e Italia me nga 2 përqind secila, dhe në një përqindje më të vogël nga SH.B.A.-të e Kanada (nga 2 përqind secila). Në dy vitet e fundit të hyrat nga dërgesat e emigrantëve në Kosovë janë rritur me një trend të ngadalësuar. Kjo për arsye se edhe papunësia në vendet e BE-së është rritur dhe kushtet e punësimit në përgjithësi janë përkeqësuar. Përkundër zhvillimeve pozitive në dy tremujorët e parë të vitit 2011 në Eurozonë, tremujori i tretë përsëri shënoi rritje të papunësisë në këto vende.

Figura 21. Pranimet e dërgesave të emigrantëve, në milionë euro



Burimi: BQK (2011)

⁴ Rritja më e lartë e transfereve rrjedhëse në shtator të vitit 2010 prej 78 përqind reflekton rritjen e stafit dhe shpenzimeve tjera të ndërmarrja nga EULEX-i gjatë vitit 2010.

4.2 Llogaria kapitale dhe financiare

Llogaria kapitale dhe financiare vazhdon të karakterizohet me bilanc pozitiv, duke shënuar vlerën prej 475.0 milionë euro në shtator 2011 (rritje prej 54.6 përqind krahasuar me shtatorin e vitit 2010). Bilanci i llogarisë kapitale arriti në 20.7 milionë euro në shtator 2011, krahasuar me 18.5 milionë euro në shtator 2010, e përbërë nga donacionet për qeverinë. Llogaria financiare e cila përbëhet nga Investimet e Huaja Direkte (IHD), portfolio investimet

si dhe investimet e tjera kishte bilanc prej 454.3 milionë euro. Siç është paraqitur në figurën 22, kontribuuesi kryesor në kuadër të llogarisë financiare vazhdon të jetë kategoria e investimeve tjera, e pasuar nga IHD-të, ndërsa ndikim në zvogëlimin e bilancit pozitiv të llogarisë financiare vazhdon të ketë rritja e vazhdueshme e portfolio investimeve dhe asetëve rezervë jashtë ekonomisë së Kosovës.


4.2.1 Investimet e Huaja Direkte

Investimet e Huaja Direkte deri në shtator 2011 kishin bilanc prej 285.8 milionë euro, që paraqet një rritje prej 22.9 përqind në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Niveli i IHD-ve prej 285.8 milionë euro është si rezultat i 292.7 milionë euro IHD në Kosovë, ndërsa 6.9 milionë euro investime të rezidentëve të Kosovës në vende tjera.

Siç është paraqitur edhe në figurën 23, IHD-të në Kosovë gjatë pesë viteve të fundit kanë mbajtur një


nivel të ngjashëm prej mesatarisht rreth 9 përqind të PBB-së, ndërsa në vitet 2007 dhe 2008 është regjistruar niveli më i lartë, që në masë të konsiderueshme i adresohet licencimit të kompanisë së dytë të telefonisë mobile dhe investimeve të ndërmarra nga kjo kompani. Si rezultat i krizës, gjatë vitit 2009 IHD-të shënuan rënien më të theksuar, ndërsa në vitet 2010-2011 vlera e këtyre investimeve filloi të rritet përsëri me gjithë se me një ritëm të ngadalshëm. Investimet e Huaja Direkte në Kosovë vazhdojnë të jenë mjaft të ndjeshme ndaj zhvillimeve në ekonominë e vendeve të Eurozonës, të cilat njëkohësisht paraqesin burimin kryesor të IHD-ve në Kosovë. Përkundër rikuperimit relativisht të ngadalshëm, Kosova vazhdon të jetë ndër performuesit më të mirë rajonal sa i përket IHD-ve duke u bazuar në indeksin e performancës së IHD-ve për vitin 2010. Vlerësimet për vitin

Figure 22. Llogaria Financiare neto, në milionë euro



Burimi: BQK (2011)

Figura 23. Investimet e Huaja Direkte si përqindje e PBB-së



Burimi: BQK (2011)

2011 nuk mund të paraqiten për shkak të mungesës së të dhënave në nivel të rajonit (Kutia 2).

Kutia 2. Performanca e IHD-ve në Kosovë⁵

Bazuar në rezultatet e indeksit të performancës së IHD-ve, vërehet se rajoni i EJJ-së ka performancë pozitive në kontekst të IHD-ve. Përkundër performancës pozitive, duhet theksuar se të gjitha vendet e rajonit kanë shënuar rënie në performancë, me përjashtim të Kosovës dhe Shqipërisë të cilat edhe gjatë vitit 2010 rritën performancën e IHD-ve. Indeksi i Performancës së IHD-ve në Kosovë arriti në 4.8, që paraqet një performancë (tërheqje të IHD-ve) relativisht të mirë në raport me madhësinë e ekonomisë së Kosovës. Shqipëria paraqet gjithashtu një vend ku indeksi i performancës së IHD-ve vazhdimisht është rritur. Në Shqipëri indeksi i performancës së IHD-ve në vitin 2010 shënoi ngritje në 5.2 që paraqet një rritje të theksuar në krahasim me vitin 2007 kur ky indeks shënonte 1.6. Edhe pse me një rënie të dukshme në performancë, me pozicion më të mirë rajonal vazhdon të jetë Mali i Zi me vlerë të indeksit prej 10.7.

Tabela 1. Indeksi i performancës së IHD-ve

Përshkrimi	2007	2008	2009	2010
Shqipëria	1.64	2.63	4.16	5.25
Kosova	3.44	3.28	3.77	4.87
Bosnja e Hercegovina	3.61	1.99	1.53	0.79
Bullgaria	7.85	6.37	5.03	2.80
Mali i Zi	6.32	7.14	16.39	10.72
Serbia	2.33	2.12	2.30	1.98
Kroacia	2.25	2.18	2.23	0.34
Maqedonia	2.27	2.10	1.39	1.3
IHD-ja në EJJ	3.99	3.26	3.23	2.00

Burimi: BQK 2010

Burim potencial për IHD-të në Kosovë janë edhe emigrantët kosovarë. Kapacitetet investive të emigrantëve kosovarë vlerësohen si mjaft të larta dhe se kursimet e tyre gjatë një viti tejkalojnë shumën prej 1.5 miliardë euro (Havolli dhe Jazbec, 2011). Gjatë dekadës së fundit, diaspora kosovare ka pasur pjesëmarrje të rëndësishme në nivelin e përgjithshëm të IHD-ve, të cilat kryesisht kanë qenë të orientuara në blerjen e patundshmërive, por edhe në aktivitete tjera ekonomike. Emigrantët kosovarë gjithashtu kanë qenë pjesëmarrës të rëndësishëm në procesin e privatizimit, proces ky i cili konsiderohet se ka tërhequr nivel të konsiderueshëm të IHD-ve në Kosovë. Në studimin e Havollit dhe Jazbec (2011) janë konsideruar faktorët të cilët përcaktojnë nivelin e IHD-ve nga emigrantët në Kosovë. Bazuar në këtë studim, janë tre faktorë të cilët në masë të konsiderueshme ndikojnë në vendimin e emigrantëve për të investuar; 1) moshja e emigrantit, 2) perceptimet e emigrantit mbi ambientin biznesor në Kosovë si dhe 3) të ardhurat e emigrantit. Konstatim bazë në këtë hulumtim është se perceptimet e emigrantëve për mjedisin e biznesit në Kosovë konsiderohen si faktori kryesor në rritjen e probabilitetit për të pasur investime nga emigrantët. Kjo tregon se probabiliteti për të investuar në Kosovë rritet nëse emigranti percepton mjedisin e biznesit në Kosovë si të favorshëm. Kjo gjetje është e rëndësishme sepse politikat mund të orientohen për të reflektuar pozitivisht tek


⁵ Indeksi i performancës së IHD-ve matë nivelin e IHD-ve në një ekonomi duke marrë për bazë madhësinë e asaj ekonomie. Formula e llogaritjes së indeksit të performancës së IHD-ve është: $IHDx = \frac{IHD_t}{IHD_{2007}}$. Në këtë ekuacion, IHDx paraqet indeksin e performancës, ndërsa IHD_t paraqet shumën e IHD-ve në ekonominë *t* dhe IHD₂₀₀₇ shumën e IHD-ve në nivel global. PBB_t paraqet PBB-në e ekonomisë *t*, ndërsa PBB₂₀₀₇ paraqet PBB-në globale.

emigrantët, duke e bërë mjedisin e Kosovës më tërheqës për investimet e emigrantëve. Rritja e investimeve të emigrantëve do të reflektonte pozitivisht edhe te investitorët e huaj, pasi që emigrantët do të shërbenin si sinjal pozitiv për këta investitorë dhe do të mund të ndikohej në përgjithësi për promovimin e ekonomisë së Kosovës.

Në nivel makroekonomik, në punimin e Kicmarit (2009) janë vlerësuar faktorët të cilët ndikojnë në tërheqjen e investimeve të huaja direkte në vendet e Evropës Qendrore dhe Juglindore. Gjetjet e këtij punimi konstatojnë se faktorët kryesor që përcaktojnë nivelin e IHD-ve në këto vende janë madhësia e ekonomisë, potenciali i tregut, hapja tregtare ndaj vendeve tjera por edhe integrimi ekonomik i këtyre vendeve me vendet tjera të botës. Gjithashtu edhe procesi i privatizimit në shumicën e vendeve konsiderohet si faktor shumë i

rëndësishëm që ka ndikuar në tërheqjen e IHD-ve në këtë rajon. Një tjetër faktor i rëndësishëm për përcaktimin e IHD-ve për rajonin e Evropës Qendrore dhe Juglindore konsiderohet edhe stabiliteti makroekonomik. Prandaj, duket se zgjerimi i tregut është një ndër motivet kryesore për hyrjet e IHD-ve në rajonin e Evropës Qendrore dhe Juglindore. Sa i përket Kosovës, duke pasur parasysh marrëveshjet e tregtisë së lirë me vendet e rajonit; preferencat tregtare me Bashkimin Evropian; stabilitetin makroekonomik; hapjen tregtare; vazhdimësinë e procesit të privatizimit; mund të thuhet se qëndron relativisht mirë për sa i përket faktorëve të lartcekur.

Figura 24. Struktura e IHD-ve sipas formës së investimit




Burimi: BQK (2011)

Investimet e rezidentëve kosovarë jashtë ekonomisë së Kosovës kanë formën e investimeve kapitale, të cilat në të shumtën e rasteve përbëhen prej blerjes së patundshmërive jashtë vendit. Sa i përket IHD-ve në Kosovë, sipas formës së investimit, 73.2 përqind e tyre janë investime kapitale, të cilat deri në shtator 2011 ishin për 22.0 përqind më të larta krahasuar me një vit më parë. Në kuadër të IHD-ve të pranuar në Kosovë, 14.2 përqind janë në formë të investimeve të fitimit të pashpërndarë, ndërsa investimet e formave tjera (kryesisht të përbëra nga kreditë ndërmjet ndërmarrjeve) janë 12.6 përqind dhe kanë shënuar rritje të theksuar nga 13.6 milionë euro sa ishin në shtator 2010 në 36.9 milionë euro deri në shtator 2011.

IHD-të në Kosovë kryesisht janë përqendruar në sektorët e ekonomisë si ndërtimtaria me 24.8 përqind, prodhimtaria me 18.8 përqind, sektori financiar me 17.4 përqind, patundshmëria me 16.9 përqind, përcjellë nga sektori i transportit dhe telekomunikacionit me një pjesëmarrje prej 11.9 përqind të gjithsej IHD-ve. Siç është paraqitur edhe në figurën 25, viti 2011 ishte kryesisht i ngjashëm me vitin 2010 për sa i

Figure 25. Investimet e huaja direkte sipas sektorit ekonomik, në përqindje




Burimi: BQK (2011)

përket strukturës së IHD-ve. Industria e procesimit ka shënuar një rënie të theksuar gjatë kësaj periudhe, ndërsa rritja më e lartë vërehet në sektorin e transportit dhe telekomunikacionit.

Vendet e BE-së vazhdojnë të paraqesin burimin kryesor të IHD-ve në Kosovë. Për dallim nga viti i kaluar, kur pjesa më e madhe e IHD-ve kishte për vend të origjinës Gjermaninë (25 përqind të gjithëj IHD-ve), në periudhën janar-shtator 2011, Britania e Madhe paraqet vendin prej nga kanë ardhur më së shumti IHD në Kosovë (23.4 përqind të gjithëj IHD-ve). Rritje të theksuar të IHD-ve ka pasur edhe nga Turqia, që gjatë kësaj periudhe paraqet vendin e tretë për nga shuma e IHD-ve. Përveç këtyre, Zvicra, Austria, Sllovenia dhe SHBA, vazhdojnë të jenë vende me nivel të konsiderueshëm të IHD-ve në Kosovë (Figura 26).

Figura 26. Investimet e huaja direkte sipas vendit të origjinës, në përqindje



Burimi: BQK (2011)

4.2.2 Portfolio investimet, investimet tjera dhe asetet rezervë

Portfolio investimet jashtë vendit deri në shtator 2011 shënuan rënie në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Vlera e portfolio investimeve arriti në 126.9 milionë euro në shtator 2011 (187.5 milionë euro në shtator 2010). Portfolio investimet në masë të konsiderueshme duket se reflektojnë perceptimet e institucioneve financiare vendore mbi ambientin e përgjithshëm në tregjet globale financiare. Nga shuma prej 126.9 milionë euro, pjesa më e madhe e tyre (75.3 përqind) janë investime të fondeve pensionale në instrumente të ndryshme financiare jashtë vendit. Pjesëmarrja e fondeve pensionale në gjithëj portfolio investimet është më e madhe krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Pjesa e mbetur prej 24.7 përqind e portfolio investimeve paraqet investimet e bankave lokale në instrumente të tregjeve financiare.

Kategoria e investimeve tjera, si njëra ndër kategoritë më me peshë në kuadër të llogarisë financiare kishte një bilanc prej 327.5 milionë euro. Bilanci pozitiv i kësaj kategorie deri në shtator 2011 shënoi rënie për 23.7 përqind krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak (429.0 milionë euro në shtator 2010). Rënia e nivelit të investimeve tjera është rezultat i rënies së aseteve për 34.0 përqind (64.7 përqind e gjithëj investimeve tjera), si dhe rritjes së detyrimeve prej 7.1 përqind (32.3 përqind e gjithëj investimeve tjera).

Vlera e aseteve në kuadër të investimeve tjera deri në shtator 2011 arriti në 212.1 milionë euro dhe përbëhen nga tërheqjet e depozitave të plasuara në vitet paraprake jashtë ekonomisë së Kosovës. Në anën tjetër, gjatë kësaj periudhe gjithashtu kishte dalje (zvogëlim të aseteve) në emër të kredive ndaj institucioneve jorezidente.

Detyrimet në kuadër të investimeve deri në shtator 2011 arritën vlerën prej 115.4 milionë euro. Komponenti kryesor në detyrimet e investimeve tjera vazhdon të jetë kategoria e kredive tregtare, të cilat gjatë kësaj periudhe arritën vlerën e 91.2 milionë euro (rritje për 44.6 përqind). Rritja e kredive tregtare mund të jetë indikatorë i aftësisë paguese të

kompanive vendore, por gjithashtu mund të shërbejë edhe si matës i besueshmërisë të kompanive ndërkombëtare ndaj kompanive vendore. Pjesëmarrje të konsiderueshme në kuadër të detyrimeve kanë edhe kreditë nga institucionet ndërkombëtare ndaj ekonomisë së Kosovës, vlera e të cilave arriti në 44.7 milionë euro deri në shtator 2011 (20.9 milionë euro deri në shtator 2010).

Asetet rezervë deri në shtator 2011 rritën për 32.2 milionë euro. Norma e rritjes së aseteve rezervë, në kuadër të Bilancit të Pagesave, gjatë periudhës raportuese ishte dukshëm më e ulët në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Sidoqoftë, mund të konsiderohet se asetet rezervë në Kosovë nuk kanë rëndësi të madhe në krahasim me shumicën e vendeve tjera, marrë parasysh se në Kosovë përdoret valuta euro, e cila është e pranueshme në çdo transaksion ndërkombëtar (Kutia 3).

Kutia 3. Llogaria Rrjedhëse në kushte të euroizimit

Qëndrueshmëria e llogarisë rrjedhëse të bilancit të pagesave paraqet sfidë mjaft të rëndë për shumë vende. Vendet e rajonit të Evropës Juglindore ballafaqohen me deficit të llogarisë rrjedhëse, që kryesisht vjen si rezultat i mungesës së konkureshmërisë dhe produktivitetit. Si indikator i problemeve me konkureshmëri dhe produktivitet konsiderohet deficit i lartë tregtar. Sidoqoftë, në disa nga vendet e EJJL-së gjatë viteve të fundit kishte përmirësime në bilancin e llogarisë rrjedhëse.

Në ekonominë e Kosovës, deficit i llogarisë rrjedhëse vazhdimisht ka shënuar rritje, duke u ndikuar kryesisht nga rritja e deficitit tregtar. Faktorët që ndikojnë në thellimin e deficitit tregtar janë të shumtë duke përfshirë rritjen e vazhdueshme të kërkesës së brendshme, revalorimi i valutës vendore ndaj disa valutave rajonale, nivelin e ulët të produktivitetit në ekonominë vendore si dhe mosshfrytëzimin e mjaftueshëm të kapaciteteve ekzistuese prodhuese në ekonomi. Mbizotërimi i niveleve të larta të deficitit tregtar në vendet e rajonit gjithashtu është edhe reflektim i tranzicionit, i cili në shumë raste është karakterizuar me kolaps të prodhimit.

Përkundër faktit se deficit i llogarisë rrjedhëse kontribuon negativisht në rritjen ekonomike, në Kosovë, qëndrueshmëria e këtij deficit nuk konsiderohet si rrezik për goditje ndaj ekonomisë nga ndryshimet në normën e këmbimit. Kosova në përgjithësi nuk rrezikohet nga goditjet ndaj normës së këmbimit si dhe besimit të publikut ndaj valutës për shkak të përdorimit të euros. Një shkallë e lehtë e rrezikut në kontekst të normës së këmbimit vjen nga disa produkte të caktuara (si p.sh. derivatet e naftës), të cilat tregtohen në dollarë amerikan, prandaj ndryshime të theksuara ndërmjet euros dhe dollarit mund të ndikojnë në çmimet këtyre produkteve dhe rrjedhimisht në thellimin e deficitit tregtar. Rrethanë tjetër lehtësuese për qëndrueshmërinë e llogarisë rrjedhëse në Kosovë është fakti se partnerët kryesor tregtarë të Kosovës janë ose plotësisht ose në masë të madhe të euroizuar. Për shembull, përderisa vendet me valutë kombëtare përdorin borxhin e jashtëm për të intervenuar në rezervat valutore me qëllim të ruajtjes së stabilitetit të normës së këmbimit Kosova nuk ka nevojë të hyjë në borxh për këto qëllime pasi që partnerët kryesor tregtarë të Kosovës janë vende të Eurozonës. Po ashtu, euro është valutë e cila mbahet rezervë nga shumica e vendeve të CEFTA-s, prandaj çdo transaksion në këtë valutë është lehtë i realizueshëm.

Politikat monetare të bankave qendrore të partnerëve kryesor tregtar janë kryesisht të orientuara në mbajtjen e stabilitetit të normës së këmbimit ndaj valutës euro, prandaj norma nominale efektive e këmbimit (*angl*; nominal effective exchange rate: NEER) ndërmjet Kosovës dhe partnerëve tregtarë nuk ka pësuar lëvizje të mëdha si rezultat i politikave monetare të cilat ndiqen nga vendet e EJJL-së. Ndërsa, norma reale efektive e këmbimit është karakterizuar me revalorim të normës së këmbimit të valutës në Kosovë ndaj partnerëve tregtar, e nxitur nga rritja e indeksit të çmimeve të konsumit në Kosovë.

Tema Specifike*

* Pikëpamjet e shprehura në temat specifike janë të autorit ose autorëve dhe jo domosdoshmërisht paraqesin qëndrimin zyrtar të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës. Temat specifike paraqesin hulumtim në progres nga autori ose autorët dhe janë publikuar për të hapur diskutime dhe komente.

5. Shfrytëzimi i Kapaciteteve Prodhuese në Nivel të Firmave në Ballkanin Perëndimor: Rezultatet nga BEEPS 2009

Sokol HAVOLLI* dhe Albulenë KASTRATI^a

5.1. Hyrje

Ky studim ka për qëllim të identifikojë normën e shfrytëzimit të kapaciteteve prodhuese në nivel të firmave dhe faktorët të cilët mund të kenë ndikim në këtë normë për firmat prodhuese në vendet e Ballkanit Perëndimor duke u bazuar në të dhënat e anketës BEEPS2009 (*angl. Business Environment and Enterprise Performance Survey*). Kjo temë mjaft e rëndësishme nuk është hulumtuar shumë, ndërsa konsiderohet si njëra ndër shkaktarët kryesor në rritjen e hendekut të prodhimit në rajon. Gjithashtu, shfrytëzimi i kapaciteteve është i rëndësishëm kur merret pasur parasysh se shumë nga vendet në Ballkanin Perëndimor ballafaqohen me deficit të lartë tregtar dhe me mungesë të konkurrueshmërisë. Përdorimi i plotë i kapaciteteve prodhuese do të reflektohej në zvogëlim të deficitit tregtar. Statistikat përshkruese të paraqitura në këtë artikull sugjerojnë se një pjesë relativisht e madhe e kapaciteteve prodhuese për firmat në Ballkanin Perëndimor mbetet e pashfrytëzuar, ndërkohë që përcaktuesit potencial për normën e shfrytëzimit të kapaciteteve janë të lidhura kryesisht me infrastrukturën e vendeve të përzgjedhura si dhe konkurrencën me të cilën firmat rajonale përballen. Përveç kësaj, problem i rëndësishëm në vendet e rajonit konsiderohet edhe ekonomia joformale e cila në masë të madhe paraqitet si pengesë për firmat e anketuara në BEEPS 2009.

Bazuar në të dhënat e BEEPS 2009, në nivel global, firmat shfrytëzojnë rreth 73.2 përqind të kapaciteteve prodhuese. Shkalla e shfrytëzimit të kapaciteteve prodhuese të firmave që operojnë në Evropën Lindore dhe Azinë Qendrore, që kryesisht përfaqësojnë vende në zhvillim, është rreth 72 përqind. Ndërsa, mesatarja e vendeve të EJK-së tregon për një nivel më të lartë të shfrytëzimit të kapaciteteve prodhuese (78.1 përqind, mesatarja e thjeshtë). Mirëpo, niveli i shfrytëzimit të kapaciteteve prodhuese në krahasim me vendet e zhvilluara vazhdon të jetë i ulët pasi që niveli i shfrytëzimit të kapaciteteve në vendet e zhvilluara arrin në 85.7 përqind. Me nivelin më të lartë të shfrytëzimit të kapaciteteve prodhuese në rajon paraqitet Kroacia (85.1 përqind kapacitete të shfrytëzuara) dhe Mali i Zi (76.5 përqind kapacitete të shfrytëzuara).

5.2. Përcaktuesit potencial të shfrytëzimit të kapaciteteve prodhuese

Kapaciteti prodhues, paraqet sasinë maksimale që mund të prodhohet përmes shfrytëzimit të të gjitha burimeve ekzistuese të firmës si makineria, kapitali dhe forca punëtore. Megjithatë, niveli i shfrytëzimit të kapaciteteve prodhuese të firmës, jo çdoherë shfrytëzohet plotësisht. Kapaciteti prodhues, me makinerinë dhe fuqinë punëtore në dispozicion, mund të jetë i nën-shfrytëzuar (shfrytëzimi i kapaciteteve prodhuese nën 100 përqind) si dhe i mbi-shfrytëzuar (Ayaagri et al., 2007).

* Sokol Havolli është Ekonomist i Lartë në Departamentin e Stabilitetit Financiar dhe Analizave Ekonomike në BQK.

^a Albulenë Kastrati është Ekonomiste në Departamentin e Stabilitetit Financiar dhe Analizave Ekonomike në BQK.

Shfrytëzimi i kapaciteteve prodhuese të firmës paraqet një koncept ekonomik, rëndësia e të cilit po rritet vazhdimisht. Megjithatë, literatura në këtë fushë vazhdon të jetë e pazhvilluar dhe definicioni i këtij koncepti nuk mund të thuhet se është i prerë. Niveli i shfrytëzimit të kapaciteteve prodhuese të firmave paraqet një indikator të rëndësishëm në vlerësimin e hendekut të prodhimit në ekonomi (Graff dhe Sturm, 2010). Po ashtu, niveli i shfrytëzimit të kapaciteteve prodhuese të firmës gjithashtu tregon për nivelin e efikasitetit të përdorimit të resurseve ekzistuese në firma. Në nivel makroekonomik, shfrytëzimi i kapaciteteve prodhuese paraqet raportin në mes të prodhimit aktual dhe atij potencial (Baccardo, 2004). Në nivel të firmës, shfrytëzimi i kapaciteteve prodhuese, zakonisht definohet si niveli i kapacitetit prodhues që firma shfrytëzon për të gjeneruar mallra dhe shërbime (Aloi dhe Dixon, 2002).

Niveli i shfrytëzimit të kapacitetit prodhues të firmës paraqet një indikator të ndryshueshëm, i cili ndryshon varësisht nga kushtet e kërkesës së jashtme për produkte dhe shërbime, si dhe varësisht nga mundësitë e prodhimit të firmës dhe menaxhimit të faktorëve të prodhimit (Shapiro, 1989). Për shembull, nën-shfrytëzimi i kapaciteteve prodhuese mund të jetë fenomen i përkohshëm, mund të reflektojë rënie të kërkesës për atë produkt, apo edhe si pasojë e sjelljes së ciklit biznesor në një kohë të caktuar. Gjithashtu, niveli i shfrytëzimit i plotë i kapaciteteve prodhuese, jo domosdo paraqet normë optimale për firmën. Po ashtu, në raste të caktuara, mund të jetë strategji e vetë firmës të operojë përkohësisht me kapacitete të nën-shfrytëzuara dhe të ulë prodhimin. Një nga faktorët që mund të ndikojë që firma të shfrytëzojë normë më të lartë të kapacitetit prodhues dhe të rrisë prodhimin është niveli i shitjeve të firmës. Nëse shitjet e firmës rriten, atëherë edhe prodhimi i firmës pritet të rritet. Mirëpo, nëse shitjet e firmës pritet të rriten atëherë firma mund të rrisë prodhimin e tanishëm, në mënyrë që të përmbushë rritjen e kërkesës për shitjet në të ardhmen.

Hapja ekonomike dhe promovimi i eksporteve është njëri nga faktorët që mund të motivojë firmat që të eksportojnë, dhe kësi soji të shfrytëzojnë resurset e tyre në mënyrë më efektive (Boccardo, 2005). Vendimi për të marrë pjesë në tregje të reja dhe firma të përfshihet në eksporte mund të çojë në përmirësimin e produktivitetit, rrjedhimisht shfrytëzimit më të lartë të kapaciteteve prodhuese (Damijan dhe Kostevc, 2005). Kjo për arsye se pjesëmarrja në tregjet e jashtme paraqet një mundësi shtesë që firma të plasojë produktet e saja. Kjo paraqet një nxitje për firmën që të rrisë kapacitetin prodhues, në krahasim me rastin kur firma prodhon vetëm për tregun vendor. Hapja ekonomike dhe përfshirja e firmave në aktivitet eksportues konsiderohen veçanërisht të rëndësishme për vendet në zhvillim, siç janë vendet e rajonit (Biesbroeck, 2003; Blalock dhe Gertler, 2004).

Ekspozimi i firmave vendore në tregjet e jashtme përmes eksporteve gjithashtu mund të rrisë edhe presionin konkurrues ndaj tyre. Firmat që eksportojnë në mënyrë aktive janë të ekspozuara ndaj një presioni më të madh konkurrues dhe janë të shtyra që të përmirësohen më shpejtë në krahasim me firmat që prodhojnë vetëm për tregun lokal. Rritja e konkurrencës pritet të ketë efekt pozitiv në efikasitetin e shfrytëzimit të resurseve ekzistuese të firmës dhe rrjedhimisht edhe në rritjen e produktivitetit (Fagnart et al., 1997). Firmat vendore që synojnë tregjet ndërkombëtare janë më të motivuara që të rrisin investimet në teknologji dhe në operacione me qëllim të një shfrytëzimi më të mirë të kapaciteteve prodhuese. Po ashtu, një mobilizim më efikas i resurseve të nënshfrytëzuara nga të gjithë sektorët e ekonomisë mund të reflektohet në një performancë më të mirë ekonomike (McCulloch et al., 2010).

Qasja në financa po ashtu paraqet një nga faktorët më të rëndësishëm, veçanërisht për vendet në tranzicion e cila mund të ndikojë nivelin e shfrytëzimit të kapaciteteve prodhuese. Qasja në financa e rritë aktivitetin dhe operacionet e firmës dhe rrjedhimisht e rritë edhe efikasitetin e shfrytëzimit të kapaciteteve prodhuese. Në bazë të të dhënave të BEEPS-it tregohet se nga të gjithë firmat nga vendet e Ballkanit Perëndimor që kanë aplikuar për kredi, rreth 6.5 përqind e tyre janë deklaruar se aplikacionet e tyre janë refuzuar për kredi. Në vendet e rajonit është e shprehur edhe dukuria e “vetë selektimit” të firmave, të cilat për shkak të barrierave që i perceptojnë nuk vendosin që të aplikojnë për kredi. Pengesat e firmave në marrjen e kredive apo edhe burimeve tjera të financimit mund të pengojë zhvillimin e firmave dhe vendimet për investime shtesë dhe rrjedhimisht mund të çojnë deri te norma më e ulët e shfrytëzimit të kapacitetit prodhues (Claessens dhe Tzioumis, 2006; Rahaman, 2011).

Pronësia e firmës gjithashtu konsiderohet si njëra ndër karakteristikat e rëndësishme mbi performancën e përgjithshme të firmës. Sipas Kiçmari (2009), firmat e huaja mund të kenë performancës më të mirë në rast se janë të nxitura nga motivi i rritjes së efikasitetit, ndërsa nëse janë në kërkim të qasjes në treg, efikasiteti nuk është objektiv parësor i tyre.

Shërbimet infrastrukturore, si furnizimi me rrymë dhe ujë të rregullt, paraqesin faktorë kyç në mbarëvajtjen e operacioneve të firmës. Studimet kanë treguar se furnizimi i pamjaftueshëm me energji elektrike ndikon negativisht në produktivitetin e firmës, në vendimet për investime dhe në kapacitetin prodhues (Dollar et al., 2005).

Përveç faktorëve që u përmendën më lartë që mund të kenë ndikim direkt në nivelin e shfrytëzimit të kapaciteteve prodhuese janë edhe faktorët tjerë, apo të ashtuquajturit ‘faktorët e tretë’, efekti i të cilëve ndryshon nga shteti në shtet. Për shembull, faktorë të tillë janë marrëveshjet tregtare, stabiliteti makroekonomik, rregullimi i tregut të punës, ekzekutimi i kontratave etj. Kjo për arsye se faktorët institucionalë dhe rregullativ po ashtu ndikojnë në performancën e firmës dhe në vendimet për rritjen/zvogëlimin e kapacitetit prodhues të firmës, apo siç i definojnë Raporti Zhvillimor Global 2005: ‘Faktorët që formësojnë mundësitë dhe motivojnë firmat të investojnë në mënyrë produktive, të krijojnë vende të reja pune dhe të zgjerohen si biznese’.

5.3. Shfrytëzimi i Kapaciteteve Prodhuese nga Firmat në vendet e Ballkanit Perëndimor

5.3.1 Kosova


Kosova mbetet vendi me nivelin më të ulët të shfrytëzimit të kapaciteteve prodhuese nga firmat. Sektori i prodhimit në Kosovë shfrytëzon vetëm 63.9 përqind të kapaciteteve prodhuese, ndërsa 36.1 janë kapacitete të pashfrytëzuara. Ky nivel i shfrytëzimit të kapaciteteve përfaqëson një kontribuues të rëndësishëm në rritjen e hendekun të prodhimit në vend (Figura 5). Në nivel të industrive, industria e plastikës dhe gomës ka nivelin më

të lartë të shfrytëzimit të kapaciteteve, e cila arrin në 83.0 përqind të kapaciteteve prodhuese. Kjo industri pasohet nga industria e përpunimit të ushqimit që përdor 76.5 përqind të kapaciteteve të saj prodhuese. Prodhimi i industrisë ushqimore përbën gjithashtu një industri në rritje, sidomos kur merret parasysh rritja e vazhdueshme e kërkesës. Industria me normën më të ulët të shfrytëzimit të kapaciteteve prodhuese është ajo e mineraleve dhe produkteve jo-metalike. Edhe pse Kosova konsiderohet si ekonomi relativisht e pasur me minerale, teknologjia e vjetërsuar e kësaj industrie konsiderohet si faktor që ndikon në nivelin e ulët të shfrytëzimit të mundësive prodhuese.

Problemi i kapaciteteve prodhuese të pashfrytëzuara mund të adresohet edhe në konkurrencën e firmave vendase kundër atyre rajonale. Për shembull, importi i ushqimeve të përgatitura përfaqëson 11.8 përqind të gjithëj impoiteve, ndërsa duke përfshirë edhe produkte të tjera ushqimore të tilla si vajra, perime dhe kafshët, importi i këtyre produkteve përfaqëson rreth 20 përqind të gjithëj impoiteve. Kur merret parasysh kjo kërkesë mjaft


e lartë për produktet ushqimore, por gjithashtu edhe nivelin e lartë të kapaciteteve të pashfrytëzuara nga ana e firmave vendase, nënkupton një nivel jo të kënaqshëm të konkurrueshmërisë nga firmat vendore. Nga ana tjetër, presioni nga konkurrenca ndërkombëtare është raportuar të jetë njëri ndër shtytësit kryesor për reduktimin e kostove të prodhimit në rreth 40 përqind të firmave në Kosovë. Prandaj, presioni konkurrues nga jashtë po ndikon që firmat në Kosovë të rrisin efikasitetin, ndikim ky i cili pritët të përmirësojë pozicionin konkurrues të firmave vendore në tregjet e jashtme. Se konkurrenca

Figura 1. Shfrytëzimi i kapaciteteve prodhuese në Kosovë



Burimi: Beeps (2009)

Figura 2. Pengesat e raportuara nga firmat në bërje të biznesit në Kosovë, në përqindje



Burimi: Beeps (2009)


paraqitet si sfidë ndaj ekonomisë vendore sugjerohet edhe nga të dhënat për firmat eksportuese. Kjo pasi që niveli i shfrytëzimit të kapaciteteve prodhuese nga firmat eksportuese është në nivel më të lartë në krahasim me mesataren në Kosovë, gjë që nënkupton se për tu qasur në tregjet e jashtme, firmat duhet të rrisin efikasitetin dhe të ulin koston e prodhimit. Sipas anketës BEEPS të vitit 2009, shfrytëzimi i kapaciteteve për firmat eksportuese në Kosovë është 73.5 përqind. Si matës i përafërt i nivelit të teknologjisë ose eksperiencës së firmës mund të përdoret kohëzgjatja e ekzistencës së firmës. Firmat që operojnë pas vitit 2000 (që është pas periudhës së luftës në Kosovë) kanë nivel më të lartë të shfrytëzimit të kapaciteteve prodhuese (72.4 përqind), që mund të nënkuptojë teknologji më efikase në krahasim me firmat e themeluara para vitit 1999, për të cilat norma e shfrytëzimit të kapaciteteve është 66.8 përqind. Lidhur me madhësinë e firmës, të dhënat sugjerojnë se firmat e vogla shfrytëzojnë kapacitetet e tyre të prodhimit më shumë se kompanitë e madhësisë së mesme. Shfrytëzimi i kapaciteteve për ndërmarrjet e vogla është në 71.2 përqind, ndërsa për kompanitë e mesme shfrytëzimi i kapaciteteve është 66.5 përqind.

Problemi i shkallës së ulët të shfrytëzimit të kapaciteteve mund të jetë thelluar edhe më tej nga pengesat në furnizimin e rregullt me energji elektrike. Siç paraqitet në figurën 6, energjia elektrike si dhe perceptimet mbi korrupsionin konsiderohen si problemet më të mëdha për firmat në realizimin e biznesit të tyre në Kosovë. Konkurrenca joformale është një tjetër faktor i cili dëmton prodhimin vendas.

5.3.2 Shqipëria

Norma e shfrytëzimit të kapaciteteve prodhuese në ekonominë e Shqipërisë është 73.1 përqind, ndërsa pjesa e mbetur 26.9 përqind mbeten kapacitete të pashfrytëzuara (Figura 3). Bazuar në karakteristikat e firmave, të dhënat sugjerojnë se shfrytëzimi i kapaciteteve nga firmat eksportuese është në nivel të ngjashëm me mesataren e ekonomisë. Në anën tjetër, edhe certifikimi ndërkombëtar i produkteve nuk ka ndikuar në shfrytëzim më të lartë

Figura 3. Shfrytëzimi i kapaciteteve prodhuese, në Shqipëri




Burimi: Beeps (2007)

